



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 93/8 prot.

Tiranë më 13.3.2018

REKOMANDIM

Nr. 09, datë 13.3.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Tranzit" Sh.p.k.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 61, datë 12.02.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Tranzit" Sh.p.k, me objekt kontrolli:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi Dh.D. në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

Telekom Albania Sh.A (ish-Albanian Mobile Communications AMC), nëpërmjet prokurës së posaçme, ka autorizuar shoqërinë Tranzit Shpk të veprojë si përfaqësues i Telekom në mbledhjen e disa detyrimeve të prapambetura të klientëve të Telekom. Tranzit Sh.p.k është i autorizuar të kryejë mbledhjen e detyrimeve për grupin e klientëve që janë pjesë e listës shoqëruese të parashikuara në Prokurë. Pjesë e kësaj liste është edhe ankuesi Dh.D.

Shoqëria Tranzit Sh.p.k ka kontaktuar nëpërmjet telefonit një person familjar të ankuesit, në numrin e telefonit 0682985... duke i kërkuar të shlyejë një shumë monetare, në lidhje

me një detyrim të prapambetur i cili i referohet një kontrate shërbimi të nënshkruar nga ankuesi me shoqërinë Telekom Albania Sh.a (ish-AMC).

Nga verifikimi i kryer rezultoi se në kontratën e përdorimit të numrit të telefonit me kontratë si dhe marrjen e shërbimeve me pagesë, të lidhur ndërmjet ankuesit Dh.D dhe shoqërisë tregtare "Telekom Albania" Sh.A (ish-AMC) u konstatua se nuk është parashikuar kontaktimi i subjektit të të dhënave (zotërues i numrit të telefonit 0682985...) me qëllim njoftimin për shlyerje të detyrimeve financiare. Konstatohet se kontrolluesi nuk ka përpunuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të dhënat personale të subjekteve të cilët nuk janë objekt i kontratës së shërbimit.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ përfaqësuesit e kontrolluesit parashtruan se nuk janë dakort me konstatimet e këtij procesverbali, si më poshtë:

- *Numri telefonit 0682985..., është siguruar në një adresë Facebook. Përsa kohë nuk ka publikuar se ka kufizime në qëllimin e kontaktimit, Tranzit Shpk nuk ka pasur pengesë për ta telefonuar dhe qëllimi ishte kontaktimi i Dh.D. Numri i telefonit 0682985..., është marrë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në një burim informacioni i hapur dhe publik.*
- *Telefonimi nga Tranzit Sh.p.k në një numër telefoni të bërë publik është në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, Administrative e Penale lidhur me njoftimet.*

Lidhur me pretendimet e paraqitura me shkrim nga kontrolluesi mbi konstatimet e evidentuara nga grupi i inspektimit në procesverbalin e hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Në këtë rast, ekzistenca e pëlqimit është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të subjektit të të dhënave (familjar i ankuesit). Për sa kohë nuk është parashikuar në kontratë kontaktimi i subjektit të të dhënave (mbajtës i numrit të telefonit 0682985...), përpunimi i të dhënave të tij është i paligjshëm duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ky lloj përpunimi, pavarësisht mënyrës së sigurimit të numrit të telefonit, nuk garanton zbatimin e nenit 6/1/a të ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Të dhënat personale përpunohen vetëm: *a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;...*

Sa i përket pretendimeve të tjera të paraqitura nga kontrolluesi lidhur me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, Administrative e Penale mbi njoftimet, Zyra e Komisionerit vlerëson se ato nuk kanë të bëjnë me këtë procedurë specifike të lajmërimit të debitorit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 29, 30 dhe 31/1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Tranzit Shpk, në zbatim të neneve 5/1/a dhe 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të ketë në vëmendje përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të të dhënave personale, duke siguruar dhe provuar pëlqimin paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen dhe administrohen me qëllim kontaktimin e debitorëve.
2. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13 / 3 / 2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

